

Përfaqësimi i personave fizikë/juridikë

1. Shërbimi i Inxhinierisë Hidroteknike ushtrohet nga persona fizikë/juridikë, të certifikuar sipas dispozitave përkatëse.
2. Një ose më shumë Inxhinier Hidroteknik që ushtrojnë profesionin e tyre privatë, për të ushtruar veprimtarinë e tyre, mund të organizohen në një shoqëri tregtare, parashikuar nga legjislacioni në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
3. Vetëm inxhinieret të certifikuar mund të jenë ortakë, aksionerë dhe administratorë të një shoqërie që ushtrojnë shërbimet e inxhinierisë hidroteknike.
4. Shoqëritë me kapital dhe administrim 100% të huaja, janë të detyruar të punësojnë 50% të profesionistëve vendas;
5. Çdo Shoqëri Private, Agjenci Shtetërore, Universitet (fakultetet/departamentet), duhet të regjistrohen dhe të certifikohen në Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik, siç parashikohet në këtë ligj. Agjencitë shtetërore dhe universitetet, duhet të regjistrohen dhe të certifikohen në Urdhër, nëse kanë si politike të tyre ushtrimin e profesionit, në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës.

Legjitimiteti i Certifikatave

Në çdo rast personi fizik/juridik do të shoqërojë punën e tij me certifikatën përkatëse për ushtrimin e profesionit sipas objektit, ky dokument është i printueshëm nga sistemi i Rregjistrimit të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik. Certifikata përveç gjeneraliteteve të saj mbasi të printohet duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor dhe teknik dhe vetëm atëherë do të ketë legjitimitet të plotë për t'ju drejtuar të tretëve.

Detyrimi për regjistrim

1. Detyrohen të regjistrohen në Regjistrin e Urdhrit:
 - a) Shoqëritë tregtare të formës person juridik, me kapital privat dhe shtetëror të cilat detyrohen të regjistrohen paraprakisht pranë QKB-it;
 - b) Agjencitë Shtatore që kanë objekt dhe inxhinier që e ushtrojnë profesionin në fushat e veprimtarisë Hidroteknike;

ç) Universitetet (departamentet) që ushtrojnë profesionin në fushat e veprimtarisë Hidroteknike.

Pezullimi i veprimtarisë

1. Kur një inxhinier hidroteknik që ushtron veprimtarinë e tij private, emërohet apo zgjidhet në detyra shtetërore, administrative, publike, qendrore dhe vendore me kërkesën e tij, çertifikata për ushtrimin e veprimtarisë pezullohet për aq kohë sa zgjat detyra.
2. Për pezullimin apo rifillimin e veprimtarisë së profesionistit, personi fizik/juridik i drejtohet institucionit për të kryer shënimin përkatës në Rregjistrin e Urdhrit.
3. Inxhinieri hidroteknik mund të pezullojë me kërkesën e tij të motivuar ushtrimin e profesionit nëse do të ketë mosmarrëveshje.
4. Pezullim i përkohshëm i veprimtarisë së inxhinierit hidroteknik njëkohësisht edhe ngirja e regjistrit për personat fizikë/juridikë, bëhet drejtpërdrejtë nga Urdhri, në rastin kur nuk kryhet pagesa e kuotizacioneve vjetore brenda dy mujorit të parë të vitit.